



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2453/ 3 prot

Datë 12.10.2023

V E N D I M
Nr.1036/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.10.2023 me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ACI Engineering” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me REF-82233-10-04-2023. me objekt: “Riparimi i linjës kabllore 110 kv N/St. Kombinat – N/St. Selitë, faza e dytë.”, me fond limit 2,571,685.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16-10-2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.

Ankimues: Operatori ekonomik “ACI Engineering” ShPK, NIPT
L51609014F 31610086D dhe Adresë: Njësia Bashkiake Nr. 5,
Rruga “Abdyl Frashëri”, Ndërtesa 8, Hyrja 13, Apartamenti
07, 1019 Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.
Adrese: Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës
Km.9

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 24 e vijues,
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë
13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe
Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i
Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë
5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për
Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të
Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar
nga COVID -19”.

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05-10-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me REF-82233-10-04-2023, me objekt: “Riparimi i linjës kabllore 110 kv N/St. Kombinat – N/St. Selitë, faza e dytë.”, me fond limit 2,571,685.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16-10-2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.

II.2. Në datën 06.10.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3474 dhe me nr. 2453/2023 prot., datë 06.10.2023, e operatorit ekonomik “ACI Engineering” ShPK me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 5181/4 prot., datë 10.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2453/2 prot., datë 11.10.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor e ka pranuar plotësisht ankesën e paraqitur.

II.5. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori

ekonomik ankimues "ACI Engineering" ShPK, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

II.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar ende shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, ku të ketë pasqyruar në shtojcë ndryshimet në përputhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor:

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. 5181/4 prot., datë 10.10.2023 të autoritetit kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit OST, protokolluar me tonën me nr. 2453/2 prot., datë 11.10.2023, rezulton, se ankesa është pranuar plotësisht duke cituar se,

*Megjithate, ne menyre që të mundesohet një pjesëmarrje me e madhe e ofertuesve për këtë procedure prokurimi, si dhe punonjesit e bashkimit të kabllorëve të tensionit të lartë do të disponohen nga OE ofertues, KSHA cmon se mund të hiqet kërkesa për të disponuar punonjes të certifikuar për të punuar me terminalët 110 kV e sipër. Si përfundim, givkoime se **ankesa e paraqitur duhet pranuar plotësisht**. Per sa parashtruar me sipër, mbeshetur në pikën 3/a, të nenit 114, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe pikën 1/a, të nenit 102, të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar,*

VENDOSI: 1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga OE "ACI Engineering" ShPK..

2. Dërgimin e vendimit të arsyetuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik të OE "ACI Engineering" ShPK.

3. Heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit me objekt "Riparimi i linjes kabllorëve 110 kV N/St. Kombinat - N/St. Selite, faza e dytë", pas përfundimit të afatit të ankimimit kundër këtij vendimi, sipas legjislacionit në fuqi.

III.1.2 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar ende shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, ku të ketë pasqyruar në shtojcë ndryshimet në përputhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:

1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

a) pranimin e plotë të ankesës;

b) pranimin e pjesshëm të ankesës;

c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.6. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës nr.5181/4 prot., datë 10.11.2023, të dorëzuar pranë KPP-së në datë 11.10.2023 nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "ACI Engineering" ShPK për procedurën e prokurimit me “E hapur e thjeshtuar”, me REF-82233-10-04-2023, me objekt: “Riparimi i linjës kabllore 110 kV N/St. Kombinat – N/St. Selitë, faza e dytë.”, me fond limit 2,571,685.00 Lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16-10-2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.
2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën për ndryshimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin Nr. 5181/4, datë 10.10.2023 prot., të depozituar në KPP, me nr, 2453/2 prot., datë 11.10.2023.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të Komisionit për shqyrtimin e ankesës.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "ACI Engineering" ShPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

